

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse në çështjen penale kundër të dënuarit O.G., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit, nga neni 428 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.72/2017 datë 15.02.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PAKR.nr.109/2018 datë 19.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 01.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.72/2017 datë 15.02.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.109/2018 datë 19.04.2018.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin P.nr.72/2017 datë 15.02.2018, të dënuarin O.G. e ka liruar nga aktakuza për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPK-së. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.109/2018 e datës 19.04.2018, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.I.nr.14/2018 e datës 18.07.2018, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që të miratohet si e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka dhënë i dënuari O.G., me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar, ngase arsyet e cekura në këtë kërkesë janë ligjërisht jo të lejueshme dhe se i tejkalojnë kompetencat e bazave për të cilat paraqitet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa e Prokurorit të Shtetit nuk është e bazuar.

Prokurori i shtetit në kërkesë pretendon se: gjykata e shkallës së parë, e gjithashtu edhe ajo e shkallës së dytë, kanë shkelë esencialisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12, gabimisht dhe jo plotësisht e kanë vërtetuar gjendjen faktike, dhe për pasojë është shkelë ligji formal, shkelje këto të cilat seriozisht kanë ndikuar në ligjshmërinë e këtyre vendimeve. Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezulton se i dënuari O.G., është akuzuar se me datën 02.07.2015, rreth orës 09.05 min, në Pejë në Spitalin Rajonal- në Repartin e syve, si person zyrtar-doktor i oftamologjisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kërkuar dhe pranuar përfitim për vete, që të veprojnë në pajtim me detyrën zyrtare, ashtu që me kusht që ta operoj të

dëmtuarin F.B., nga i njëjti paraprakisht kërkon dhe i merr të holla në shumë prej 150 €. Bazuar në dispozitat e procedurës penale të KPPK, gjykata është e obliguar që në arsyetimin e aktgjykimit ti paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash e merr si të provuar apo si të paprovuara. Në rastin konkret gjykata nuk ka përfillur nenin 370 par.7 të KPPK dhe ndërmjet aktgjykimit dhe dispozitivit të aktakuzës nuk ka fare arsyetim për faktet e rëndësishme. Më pas në kërkesë pretendohet se në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata nuk akcepton dhe nuk tregon arsyen se pse ky i dënuar i kishte marr 150 €, por marrjen e këtyre të hollave e arsyeton se kinse këto të holla nuk i ka kërkuar për të hyrë në operacion por për të blerë materialin e nevojshëm për operacion. Më pastaj me kërkesë pretendohet se me provat e administruara edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, posaçërisht me dëgjimin e dëshmitarëve. Andaj, pretendohet se mos vërtetimi i saktë i gjendjes faktike dhe shkelja e dispozitave të procedurës penale kanë ndikuar edhe në shkeljen e ligjit penal ku si rrjedhojë ,gjkatat të dënuarin e kanë liruar nga akuza, duke mos konsideruar marrjen e të hollave nga pacienti si kusht për operim por kinse të holla janë marr për blerje të materialit për operacion.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të pretendimeve të Prokurorit të Shtetit, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, po ashtu në mënyrë të veçantë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Gjykata e shkallës së parë për secilën provë të administruar ka dhënë vlerësimin dhe arsyetimin. Nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se aktgjykimi është i bazuar në mbrojtjen e të dënuarit , pasi që kjo mbrojtje të dënuarit është e mbështetur edhe në prova të tjera e sidomos në dëshminë e dëshmitarit kyç siç është dëshmitari A.Sh. i cili është dhëndër i të dëmtuarit F. e i cili në të gjitha fazat e procedurës penale ka deklaruar se të gjykuarit shumë prej 150 € ia ka dhënë për blerjen e materialit për operimin e syrit duke mos e kushtëzuar të njëjtin si dhe faktin se i dëmtuari nuk është takuar me të dënuarin por të gjitha kontaktet dhe aranzhimet për operim dhe blerjen e materialit janë kryer përmes dëshmitarit A.Sh. dhe të dënuarit O.G., gjë që ka deklaruar edhe vet i dëmtuari se rastin e ka paraqitur pas tre muajve në polici ngase ka pritur që njëherë ti shërohej syri por pasi që nuk ju ka shëruar, ka vendosur të lajmëroj rastin. Pavarësisht se prokuroria pretendon se lajmërimi i rastit pas tre muaj pas operimit nuk është me rëndësi, gjykata ka vlerësuar drejt se bazuar në provat e cekura më lartë

dëshmia e të dëmtuarit nuk mund të merret si e bazuar pasi i njëjti nuk ka kontaktuar drejtpërdrejtë me të akuzuarin si dhe lajmërimin e rastit e bënë vetëm pasi që i keqësohet gjendja shëndetësore e syrit. Po ashtu drejtë kanë vlerësuar të dy gjykatat se nuk mund të aprovohet pretendimi i prokurorisë i theksuar në dispozitivin e akuzës “se i gjykuari me kusht që ta operoj të dëmtuarin, paraprakisht kërkon dhe i merr të holla në shumë prej 150 euro”, pasi që kjo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet, sepse nga dëshmia e dëshmitarit kyç A.Sh. është vërtetuar e kundërta e kësaj që ka pretenduar prokuroria. Po ashtu edhe me dëshmitë e dëshmitarëve S.D., J.G. dhe R.L. është vërtetuar se në Spitalin Regjional të Pejës në të shumtën e rasteve nuk ka pasur material për operim e që përputhet edhe me deklaratën e të dënuarit.

Prokurori i shtetit edhe pse nuk i potencon specifikisht, megjithatë nga referati i kërkesës së tij del se pretendon për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, mirëpo këto pretendime nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 432 par.2 të KPRK, pretendimet në kërkesë nuk ishin të bazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë gjegjësisht faktet jo kontestuese dhe vlerësimet e gjykatave të instancave më të ulëta, se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari O.G. ditën kritike ta ketë kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPRK.

Me çka u parashtrua e në bazë të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.195/2018, më datë 01.10.2018

Procesmbajtëse,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa

